# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-440518**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | BSPK kërkon zbatimin e zotimeve qeveritare për punëtorët |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/bspk-kerkon-zbatimin-e-zotimeve-qeveritare-per-punetoret/1010056/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 18:52:16 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 18:45:18 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5d4fcce54a67f594fe7122dc281a9c7e4bb1ec60cb060d38b8079a549f22b799` |
| TEKSTI | `7957fadfce92a51065d0fee65da72caea7acaddfbb51780109517cd5e766f768` |
| PAMJA | `943ecb8c8811ea26b12b87fc06ed8da2bc3be6076a471fc6d16b4b4127d77c42` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e5a5da7b3fc0814d3507b7354ffac8b3b5cb434ed051eda2f484da70b8dd6cf9` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e5a5da7b3fc0814d3507b7354ffac8b3b5cb434ed051eda2f484da70b8dd6cf9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# BSPK kërkon zbatimin e zotimeve qeveritare për punëtorët

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) e ka përshëndetur krijimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke shprehur shpresën se mandati i ri do të forcojë bashkëpunimin mes institucioneve dhe partnerëve socialë.

Në emër të BSPK-së, kryetari Atdhe Hykolli ka uruar Qeverinë për konstituimin, prezantimin e kabinetit qeveritar dhe paraqitjen e Programit Qeverisës.

Sindikata ka vlerësuar si pozitive angazhimet që prekin gjendjen ekonomike e sociale të të punësuarve. Në këtë kuadër, ajo ka veçuar pagën e 14-të për punonjësit e sektorit publik dhe përjashtimin nga tatimi të pagës minimale prej 500 eurosh.

Megjithatë, BSPK ka nënvizuar se vlera e këtyre premtimeve do të përcaktohet nga mënyra se si ato do të zbatohen në praktikë.

“Për BSPK-në, rëndësia e këtyre zotimeve do të matet me zbatimin e tyre dhe me ndikimin real në jetën e të punësuarve”, thuhet në komunikatën e sindikatës.

BSPK ka kërkuar që gjatë ditëve të ardhshme të përmbyllet edhe konstituimi i Këshillit Ekonomiko-Social (KES), pasi funksionalizimin e këtij mekanizmi e konsideron të domosdoshëm për zhvillimin e dialogut social.

Sipas sindikatës, menjëherë pas vënies në funksion të KES-it duhet të hapen negociatat për Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive.

“Pikërisht aty duhet të shihet fuqia e dialogut social dhe jo vetëm në zotime dhe takime, por në marrëveshje të negociuara, të nënshkruara dhe të zbatueshme”, thekson BSPK.

Vlerësimi i kryetarit Hykolli është se një demokraci funksionale nuk kufizohet vetëm te ngritja e institucioneve, por

të fundit/
BSPK kërkon zbatimin e zotimeve qeveritare për punëtorët

Bërvenica drejt zgjedhjeve të 18 tetorit me gjashtë kandidatë…

Protesta para Kryeministrisë në ditën e 106-të: “Jemi mijër…

Partizani pëson 8 gola në 4 javë, tifozët i kërkojnë presidencës…

Shaqiri shkëlqen me dy gola dhe një asistim në fitoren e Baselit ndaj…

PDK-ja të hënën kërkon interpretim nga Kushtetuesja për…

Protestuesit marshojnë drejt Kryeministrisë në ditën e 106-të të…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

kërkon edhe pjesëmarrjen e përfaqësuesve legjitimë të punëtorëve në hartimin e politikave publike.

“Ky është standardi evropian i partneritetit social dhe ky duhet të jetë edhe drejtimi ynë”, shprehet Hykolli.

BSPK ka bërë të ditur se është e gatshme të bashkëpunojë me institucionet, me synimin që dialogu social të sjellë përfitime dhe rezultate konkrete për punëtorët.

“Konkretizimi i KES-it dhe Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive të bëhen dëshmia më e qartë se partneriteti social po funksionon në dobi të punëtorëve dhe të zhvillimit të vendit”, përfundon komunikata e BSPK-së.

Shtuar më 13.09.2026 20:45

Tags: bspk , punetore , Qeveria


PDK-ja të hënën kërkon interpretim nga Kushtetuesja për…


Kurti i kërkon PDK-së të propozojë kandidatin për nënkryetar të Kuvendit


Mediat ndërkombëtare pasqyrojnë votimin e Qeverisë “Kurti 4


“Serbia kreu gjenocid ndaj shqiptarëve”/ Kurti për procesin në Hagë: Asnjë…


Kurti: Qeveria e re do t’i shërbejë qytetarit dhe do të mbrojë familjen


OVL-UÇK: Ndërkombëtarët të mos ndërhyjnë politikisht në vendimin e 16 shtatori…


Gjini: Qeveria “Kurti 4” është jokushtetuese, Aleanca do t’i drejtohet…


Gruda: PDK-ja e mban ende propozimin për nënkryetaren e Kuvendit

albeu © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko... Kërko



© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.